

## VESHJET SHQIPTARE NË SHEKUJT XIV- XV REFLEKTIM ETNOGRAFIK

### **Abstrakt**

Në këtë kumtesë bëhen përpjekje për të paraqitur modën e veshjes së shtresave të ndryshme në territoret e periudhës së Skënderbeut, në shek. XIV-XV, si dhe për të klasifikuar tipet e veshjeve gjatë kësaj periudhe. Për herë të parë trajtohet dhe miti i shprehur në shenjë zie në pjesë të ndryshme të veshjeve popullore pas vdekjes së Skënderbeut. Bazuar në burime të shkruara, në gravurat e udhëtarëve të huaj, si dhe në fotografitë e brezit të vjetër të fotografëve shqiptarë, argumentohet se veshja me tirq (e burrave) ka filluar të përdoret në gjysmën e dytë të shek. XX

**Fjalë kyçe:** Moda e veshjeve në shek. XIV-XV, tipet e veshjeve, veshja me tirq

### **Abstract**

In this paper, attempts are being made to present the fashion and dressing of different social stratum in XIV-XV century and to classify the various typologies during this period. For the first time, has been taken into consideration the myth of mourning found in various parts of the traditional costume. Based on written sources, the engravings of foreign travelers, as well as the older generation of Albanian photographers, we argue that the male felt pant (tirqe) came into use in the second half of the XX century

**Keywords:** Fashion and costume in the XIV-XV centuries; the felt pant dressing

Për veshjet popullore shqiptare është shkruar e botuar shumë, madje që në fillimet e zhvillimit të shkencës etnografike në Shqipëri. I pari është Rrok Zojzi, i cili, veç aspekteve të tjera, është ndalur hollësisht edhe në teknologjinë e përgatitjes së materialeve me të cilat bëheshin pjesët e veshjeve popullore. Më pas, Andromaqi Gjergji, e cila i thelloi më tej

studimet rreth kësaj teme, duke i kurorëzuar ato me një botim madhor, të titulluar *Veshjet shqiptare në shekuj: Origjina, tipologjia, zhvillimi* (2005).

Ndërsa në këtë kumtesë do të përpiqemi të bëjmë një etnografi të veshjeve dhe tipologjinë e tyre në shekujt XIV-XV, duke vënë përballë njëri-tjetrit disa burime, konkretisht, dokumente të shkruara të kësaj periudhe, gjetje arkeologjike të periudhës antike dhe asaj mesjetare, disa tekste këngësh të Eposit të Kreshnikëve, fondet etnografike të IAKSA-së, si dhe burime nga terreni, që sjellin kujtesën sociale lidhur me zinë e shprehur në veshjet popullore pas vdekjes së Skënderbeut.

Për sa i përket burimeve të shkruara (të cilat na informojnë për llojet e materialeve të përdorura dhe mënyrën e stilimit të veshjeve) ato janë të njëanshme, kryesisht na njohin me veshjet e shtresave të larta të shoqërisë së asaj kohe, duke përfshirë edhe klerikët e kësaj kategorie.

Në dokumentet e importit të shekujve XIII, XIV, XV, përmenden llojet e stofrave e të pëlhurave të tjera luksoze, si: *panni de grana*, *panni rubei boni*, *panni de Cumis*, *panni de Florentina* etj, të cilat kryesisht vinin nëpërmjet Venedikut.<sup>1</sup> Posaçërisht, një dokument i vitit 1433, na informon se materialet për veshjet e anëtarëve të familjes së Gjon Kastriotit, Aranit Komnenit, Kont Niketës, Gjergj Jurës etj, vinin nga Venediku (Radoniç 1942).

Të njëjtat dokumente na informojnë edhe për ngjyrat e materialeve të përdorura, të cilat ishin të përcaktuara sipas rangut të fisnikëve. Për shembull: ngjyra e purpurt, ajo e kuqe dhe e gjelbër mund të përdreshin vetëm nga fisnikët e lartë. Bazuar në afresket e kohës apo në ndonjë përshkrim të shkurtër në ndonjë dokument të hershëm, mësojmë se fisnikët ndiqnin modën bizantine, jo vetëm në veshje, por edhe në zbukurimet e kushtueshme (është fjala për stolitë). Veçanërisht, të shumta e tepër të kushtueshme ishin stolitë e përdorura nga gratë e tyre, kurora të arta, vëthë me perla e gurë të çmuar, diadema, pafte, breza etj. Të gjitha këto ishin elementë të pamungueshëm sipas dokumenteve të viteve 1393, 1399, 1400 etj.<sup>2</sup> Breza dhe pafte të këtilla vazhduan të përdoren edhe në shekujt e mëvonshëm, madje deri në shekullin XIX.

<sup>1</sup> *Acta et diplomata*, vëll II, dok. 312, 386, 737 (cituar sipas Gjergji 2005, 69)

<sup>2</sup> *Acta et diplomata*, vëll I, dok 186 (cituar sipas: Gjergji 2005, 19).

Veshjet e burrave në shekullin XIV përbëheshin nga pjesë të tilla, si: një lloj këmishe e ngushtë, sako e gjatë me mëngë të shkurtra deri në bërryl me disa lapa që vareshin. Përgjithësisht ishte një veshje e rëndë, e ngrirë nga zbukurimet e shumta.

Po kështu, edhe veshja e grave (sipas afreskeve) paraqitet mjaft luksoze. Në kokë mbanin një mbulojë prej pëlhere të hollë, e cila për nga mënyra e lidhjes na kujton gratë e Dropullit dhe ato të krahinës së Hasit. Në të shumtën e herës qepja e veshjeve bëhej në vend, pasi në disa qytete, si: Vlora, Shkodra, Berati, Pulti etj, lulëzonin një varg mjeshtërish, përfshirë edhe ato të luksit. Në shekullin XV veshja pësoi disa ndryshime, ndikuar prej modës orientale. Sakoja e sipërme u zëvendësua me një lloj manteli (pellanda) që në vend të astarit kishte gëzof të shtrenjtë. Tashmë mëngët bëheshin në formë gypi të qepura tek supi dhe që kishin vetëm funksion dekorativ. Këto mëngë janë të ngjashme me ato të gunës së grave ortodokse të Mokrës apo mëngët e varura të dollamave të mbajtura nga burrat e krahinave të Mirditës, Matit e Kurbinit. Me një mantel të këtitillë të veshur me lëkurë ermellini paraqitet Skënderbeu në një portret. Ky lloj manteli ishte i përhapur, jo vetëm në vendet e Ballkanit, por deri në Venedik.

Shekujt XIV-XV janë periudha e flokëve të gjata për burrat. Kujtojmë se Teodor Muzaka mbiquhej edhe “Chiscetis” se i mbante flokët e gjata “Ksheta”.

Moda bizantine në veshje vazhdoi edhe në shekujt në vijim tek shtresat e pasura të qyteteve shqiptare, sidomos në Shqipërinë e Jugut dhe më pak në Shqipërinë e Veriut. Le të kujtojmë veshjet e grave të qytetit të Beratit, veshjen e Lunxhërisë, por edhe mbijetesa elementesh të veçantë në mëngët e xhamadanëve të Shqipërisë Veriore, dollamën e burrave të Kurbinit etj.

Për sa i përket veshjes së shtresave të gjera të popullsisë, mendohet se në pjesën më të madhe ajo prodhohej brenda ekonomisë familjare. Por, nuk mungonin edhe ato të ardhura nga importi, të cilat ishin pëlhura liri që përdreshin kryesisht nga njerëzit e shërbimit “pro servientibus”, siç thuhet në dokumentet e mesjetës para turke.<sup>3</sup> E një cilësie modeste ishte edhe një

---

<sup>3</sup> *Acta et diplomata*, vëll I, dok 385, viti 1278; dok 407, viti 1280. (cituar sipas Gjergji 2005, 20).

pëlhurë e quajtur “fustagno”, e bërë prej liri dhe pambuku. Është e sigurt që kjo lloj pëlhure është përdorur për një pjesë veshjeje për burra në formë fundi, me rrudha, që më vonë u quajt fistan apo fustanellë.

Si më i besueshëm mund të quhet një dokument i vitit 1355, ku thuhet se një marinari në portin e Drinit (afër Shkodrës), i marrin rrobat e tij, nga të cilat përmendet “tunika”, “fistani”, “manteli”, “këmisha” etj. Nga ky dokument mësojmë se “fistani”, tashmë përmendet si pjesë e veshjes, krahas këmishës.<sup>4</sup>

Në një tjetër dokument të vitit 1330, përmenden brekeshat.<sup>5</sup> Dokumente të tjera, por edhe tekstet e këngëve të Ciklit të Kreshnikëve, përmendin një lloj jeleku të bërë me lëkurën e dhenvë, xhubletën e xhupetën, lloje dollamash për burra, këmishët e gjata dhe përparjet e grave, lloje xhokash prej shajaku të bardhë. Nisur nga këto dëshmi, si dhe nga gjetjet në vendbanime të kulturës ilire apo statuetat e ndryshme të kohëve më përpara, në gjetjet e varrezave mesjetare, në të cilat janë vërejtur lloje brezash të gjerë të zbukuruar me pafta e sumbulla, zinxhirët që varen në brez, tëmthore, vëthë, unaza, gjurmë vizatimesh që paraqesin brezin “me rrema” apo me tufa, lloje strukash etj, si dhe në veshjet e arbëreshëve, afresket e kohës, mendoj se në atë periudhë, shek XIV-XV, qarkullonin katër tipe veshjesh, dy për burra dhe dy për gra, sigurisht me variantet e tyre, të cilat mbijetuan deri në shek. XIX e fillim të shek XX.

Ky klasifikim nuk synon të kundërshtojë atë të bërë nga etnografja dhe studiuesja e veshjeve popullore Andromaqi Gjergji. Klasifikimi i bërë prej saj nisat duke pasur parasysh veshjet popullore të përdorura gjatë shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, kohë kjo kur llojet e variantet e veshjeve të përdorura në krahinat shqiptare, ishin pasuruar edhe më shumë si rezultat i zhvillimit të mëtejshëm të proceseve historike sociale dhe kulturore. Në klasifikimin e bërë prej saj, janë përfshirë veshjet e mirëfillta popullore, duke pasur parasysh ato të fund shekullit XIX dhe fillim shekullit XX dhe janë lënë jashtë ato që janë ndikime të vona të qytetërimeve të huaja, të cilat u përdorën kryesisht nga shtresat më të pasura. Tipologjia është përcaktuar

<sup>4</sup> *Acta et diplomata*, vëll I, dok 790 (cituar sipas Gjergji 2005, 20)

<sup>5</sup> *Acta et diplomata*, dok. 80, dt. 13 dhjetor, Raguzë, 790 (cituar sipas Gjergji 2005, 32).

bazuar në pjesët e poshtme të veshjeve, sigurisht pa lënë mënjanë edhe ndonjë pjesë tjetër të kostumit. Përgjithësisht, pjesët e sipërme të të gjitha veshjeve janë më uniforme, kurse ato të pjesës së poshtme, paraqiten të shumëllojshme, sidomos në format e prerjes. Autorja mendon se tipologjia e këtyre të fundit, jep mundësinë të përcaktohen më mirë dallimet dhe analogjitë me popujt e tjerë të Ballkanit, ndërkohë kjo gjë mundëson të bëhen përjasje dhe krahasime midis veshjeve të shek. XIX-XX, me ato të kohës së mesme dhe periudhave më të hershme, duke u mbështetur në burime figurative, burimet e shkruara, si dhe në gjetjet arkeologjike.

Është pasur parasysh gjithashtu, edhe fakti se veshjet kanë kaluar në procese zhvillimi: disa kanë dalë nga përdorimi e të tjera janë zëvendësuar, ose diçka ka mbijetuar. Në fakt, filli i kësaj kumtese qëndron pikërisht në këtë proces zhvillimi.

Për gratë: njërit tip i përkiste veshja me xhubletë, e paraqitur në variantin e xhubletës së shkurtër, e ruajtur në krahinën e Dukagjinit dhe në variantin tjetër veshja me xhupetë, një lloj këmishë prej leshi e shoqëruar me një përparje dhe me xhupe. Tipi tjetër përfaqësohej nga veshja me këmishë të gjatë (prej liri) dhe me dy futa. Tipi i veshjes me xhubletë, e cila më pas u pasurua me variantin e xhubletës më të gjatë dhe asaj të shkurtër ka një origjinë të stërlashtë. Gjithsesi, edhe variantet e tjera të veshjes me këmishë të gjatë e dy futa janë mjaft të hershme në origjinën e tyre.

Për burra qarkullonin: tipi i veshjes me fustanellë dhe tipi me këmishë të gjatë, me mbathje të gjata e të gjera. Sipër këmishës vishej një lloj palltoje prej shajaku që më pas u quajt dollamë (në Shqipërinë e Veriut) apo cibun (në Shqipërinë e Jugut”, e cila bëhej prej shajaku në ngjyrë të bardhë. Shtresat e pasura këtë lloj palltoje e kishin prej stofi të fabrikuar dhe cilësore. Për sa i përket kësaj veshjeje, burime që duhen marrë në konsideratë janë edhe disa dëshmi fragmentare, të cilat i gjejmë në shtresëzimet e teksteve të Këngëve të Kreshnikëve. Kështu, Muji, Halili dhe agët e tjerë, herë paraqiten të veshur me qyrk, herë me kondosh e dollamë të qëndisur me ar (veshje këto tipike të modës bizantine), por nuk mungon edhe veshja me fustan.

Ndërsa gratë, motrat, vajzat e tyre si dhe nuset e rrëmbyera andej-këtej paraqiten të veshura me fustane të gjatë e me kollanë, me dollamë me sumbulla, pafte brezi etj, elemente këto tipike bizantine.

Veshja me fustanellë arriti të mbijetojë në të gjithë Shqipërinë deri në fillim të shekullit XX, duke u përqendruar më pas vetëm në Shqipërinë Jugore. Ndërsa veshja me këmishë të gjatë e dollamë nga mesi i shekullit XIX në Shqipërinë Veriore u zëvendësua me veshjen me tirq. Në Shqipërinë Jugore, kjo veshje e quajtur veshje me cibun, pas Luftës së Parë Botërore u zëvendësua me veshjen me poture. Lidhur me vazhdimësinë e përdorimit të tipeve të këtyre veshjeve të përdorura në shekujt XIV-XV, informohemi edhe nga tablotë e piktorëve të huaj, të cilët kanë udhëtuar në Shqipëri që nga fillimi i shekullit XIX e deri në fillim të shekullit XX (Hudhri 1990, 87). Në tablotë e krijuara prej tyre janë paraqitur pikërisht këto veshje që përmendëm më lart. Një veshje e re, (lloj pantallonash) e përhapur në Shqipërinë e Veriut, e cila u njoh me termat *me tirq*, *me çakçirë* ose *me zhgun*, vërehet në disa kompozime të tyre vetëm pas viteve 1860-1870.

Para kësaj periudhe, gjurmët e kësaj veshjeje për burra nuk na i ofron asnjë lloj burimi dokumentar, por nuk mund të mos përmendim faktin se veshja me fustanellë në stinët e ftohta shoqërohej me një palë kallce apo kofsharë (lloj çorapësh të gjatë) deri në rrëzë të kofshëve. Materiali me të cilin bëheshin kallcet ishte një lloj pëlhure e leshtë (e importuar) e cila quhej tirk. Me sa duket, termi *tirq* i këtyre pantallonave duhet të jetë marrë pikërisht nga emërtimi i kësaj pëlhure. Ndërsa, termi *çakçirë* është me origjinë orientale. Këto janë dukuri që i hasim edhe në emërtimin e disa pjesëve të tjera të veshjeve për burra dhe për gra në periudhën pas pushtimit turk.

Kësisoj, më duhet të saktësoj se paraqitja e Skënderbeut apo e luftëtarëve të tij me veshje me tirq në disa krijime të piktorëve shqiptarë, nuk është e saktë nga ana shkencore dhe nuk e paraqet realitetin e veshjeve të përdorura në atë kohë. Siç dihet, krijimet popullore për figurën e Skënderbeut janë të shumta. Memoria historike për kohën e tij vjen edhe nëpërmjet disa varianteve të veshjeve popullore. Gjatë ekspeditave të shumta që kam zhvilluar në terren, sidomos në krahinat që përfshijnë zonën e Librazhdit e deri në Alpet brenda dhe jashtë kufirit politik të Shqipërisë, më ka rastisur të dëgjoj shpeshherë se pjesët e veshjeve me ngjyrë të zezë, si: xhubleta e nuseve, llojet e xhurdive (të njohura me terma të ndryshëm), përparjet e grave në Malësinë e Dibrës dhe, posaçërisht, shamia e zezë apo blu e errët e grave të Mirditës, janë mbajtur në shenjë zie pas vdekjes së

Skënderbeut. Madje, burrat veriorë identifikoheshin edhe me termat “gjokazez”, “gjokazinj”.

Si përfundim, theksoj se kontributi i kësaj kumtese qëndron në përcaktimin e veshjeve të përdorura në periudhën që përfshin shekujt XIV – XV, pra në periudhën para pushimit turk. Janë pikërisht këto veshje që u rezistuan më shumë modës orientale të shfaqur pas pushtimit osman dhe rrymave të tjera kulturore në vijim.

### **Bibliografi**

- Gjergji, Andromaqi. 2005. *Veshjet shqiptare në shekuj*. Tiranë: Akademia e Shkencave.
- Hudhri, Ferid. 1990. *Albania and albanians in word art*. Athinë: Christos Giovanis
- Onuzi, Afërdita. 2009. *Albumi: Veshje popullore shqiptare*, vëllimi III. Tiranë: Akademia e Shkencave
- Radoniç, Jovan. 1942. *Djuradj Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku: istoriska gradja*. Beograd: Srpska kraljevska akademija